REPUBLIKA E SHQIPERISE

KESHILLI KOMBETAR I UJIT

# V E N D I M

Nr. 1 Date 23.04.1999

PER PROCEDUREN PER MIRATIM LEJE PER SHFRYTEZIMIN
E UJERAVE PER KONFEKSIONIM

Keshilli Kombetar i Ujit i mbledhur sot me daten 23.04.1999

## V E N D O S I

Te miratoje proceduren e meposhtme per miratim leje per shfrytezimin e ujerave per konfeksionim:

1- I drejtohet kerkesa Sekretariatit Teknik te Keshillit Kombetar te Ujit per ujin qe kerkohet per konfeksionim, ku specifikohen:

1- Emertimi i burimit, vendi ku ndodhet
2- Sasia e ujit qe kerkohet per konfeksionim
3- Kapaciteti ditor dhe vjetor i impiantit
4- Sasia e ujit qe nevojitet per sherbime

Ne rast se uji kerkohet te merret nga rrjeti egzistues i ujesjellesve kerkesa i drejtohet fillimisht ndermarrjeve perkatese, te cilat marrin edhe miratimin e pushtetit lokal, pastaj Keshillit Kombetar te Ujit (shih piken 4).

2- Merret aprovimi nga Ministria e Bujqesise dhe e Ushqimit per menyren e konfeksionimit.

3- Merret aprovimi i shesheve te ndertimit nga KRT ose KRTSh (sipas rastit).

4- Merret miratimi i Keshillit Kombetar te Ujit ne te gjitha

rastet.

5- Lidhet kontrata sipas rasteve me Sekretariatin Teknik ose me Ndermarrjen e Ujesjellesave.

Ne kontrate te pasqyrohet kushti qe me daljen e legjislacionit te ujit kontrata do te modifikohet sipas akteve ligjore e nenligjore te tij.

6- Merret leja per ndertimin (aprovimi i projektit te zbatimit ne KRT ose KRTSH).

7- Per ushtrimin e aktivitetit do te zbatohen kerkesat e legjislacionit ne fuqi.

KRYETARI I KESHILLIT KOMBETAR TE UJIT

ALEKSANDER MEKSI